

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit I. L.H.,nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Sh, T., për shkak të kthimit në punë apo vazhdimin e pagesës së pensionit duke vendosur sipas revizionit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3556/2013 datë 31.03.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.09.2016, mori këtë,

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësit I, L.H., nga Prishtina, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3556/2013 datë 31.03.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3556/2013 të dt.31.03.2016 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1252/09 dt.2.09.2013,me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit që të detyrohet e paditura që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës apo vazhdimin e pagesës së pensionit nga 105€ në muaj nga data e ndërprerjes 1.09.2009 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore me kamatë ligjore nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm si e pabazuar si dhe që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion , për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që të miratohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura, me propozim që revizioni i paditësit të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, e cila me vendimin e sajë nr..., të datës ..., ka miratuar kërkesën e paditësit për pension sipas kategorisë së parë të invaliditetit. Vendimin e ka marrë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/35 dhe Statutin e Fondit Pensional të KEK-ut. Sipas këtij vendimi pagesa e pensionit ka filluar prej datës 1.8.2004 dhe përfundon me dt. 1.9.2009, në lartësi mujore prej 105€. Palët janë këshilluar se kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrijë ankesë Komitetit për shqyrtimin e mospajtimeve përmes Administratës së Fondit Pensional, por që, i njëjti nuk është kundërshtuar asnjëherë . Nuk është kontestues fakti se paditësi është kompensuar sipas vendimit, duke filluar nga data 1.8.2004 e deri 1.9.2009 për periudhën prej 60 muaj, për çdo muaj shumën prej 105€. Pas kësaj date, paditësit i ishte ndërprerë pagesa e këtij pensioni, ndërsa, paditësi me datën 14.05.2009 ka paraqitur kërkesë për vazhdimin e pagesës së pensionit .

Duke u nisur nga gjendja e këtillë faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar pasi që paditësi me rastin e aplikimit në Fondin Pensional i ka pasur të qarta të drejtat që mund t'i realizonte me rastin e miratimit të kërkesës së tij. E paditura i ka përmbushur në tërësi obligimet ndaj paditësit dhe sipas vendimit të lartcekur, e paditura përveç detyrimit për ta paguar 5 vite përkatësisht 60 muaj pensionin në shumë prej 105€,nuk ka marrë asnjë detyrim tjetër. Vendimi i marrë nga e paditura është në pajtim me Rregulloren dhe Statutin e sipër cekur dhe vendimi i tillë është në pajtueshmëri me

Rregulloren e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë e cila parashihte mundësinë që punëdhënësi dhe punëmarrësi të përcaktojnë lirisht të drejtat dhe detyrimet reciproke në kuadër të marrëdhënies së punës, si marrëdhënie kontraktuese, siç janë përcaktuar edhe në rastin konkret, andaj, ka vendosë si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët në bazë të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, drejtë kanë aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore si dhe të drejtën materiale, kur kanë vendosur si në dispozitivin e aktgjyqimeve të tyre. Këtë qëndrim, kjo Gjykatë e mori për faktin se detyrimi i së paditurës në aspektin e kohëzgjatjes së kësaj të drejte të paditësit, nuk mund lidhet dhe të kushtëzohet me themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, por ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit është e lidhur me periudhën e përcaktuar me vendimin e dt.7.09.2004, nga data 1.08.2004 e deri 1.09.2009. Në bazë të vendimit të lartcekur, të cilin vendim paditësi nuk e ka kontestuar, saktësisht është përcaktuar kohëzgjatja e detyrimit të së paditurës që paditësit t'ia kompensojë pagesën e pensionit deri me dt.1.9.2009, ky detyrim nga ana e së paditurës është përmbushur në tërësi për periudhën prej 5 vite(60-muaj), për çdo muaj në shumë prej 105€, ashtu siç qëndron në vendim. Prandaj, kërkesëpadia e paditësit për kthim në punë apo vazhdimin e pagesës, nuk ka mbështetje ligjore për faktin se paditësi dhe e paditura kanë përcaktuar lirisht të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella në kuadër të marrëdhënies së punës dhe vendimi si së paditurës është marrë në bazë të vullnetit të paditësit, me ç' rast marrëdhënia e punës i është shndërruar në marrëdhënie kontraktuese, ashtu siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykatat e instancës më të ulët. Prandaj, janë të pathemelta thëniet në revizionin e paditësit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale e përkitazi me refuzimin e kërkesëpadiisë së paditësit si të pabazuar. Poashtu, Gjykata e Revizionit, në vështrim të nenit 215 të LPK-së, nuk ka gjetur shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës , konstaton se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë, ka mbështetje edhe në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.1 Kl.128/2012 nr. Ref. RK 441/13 dt.3.03.2013.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.215/2016 datë 13.09.2016

Kryetari kolegjit
Mr.Sc.Muhamet Rexha